



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE**

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383-38-249-873 • E-mail: fshmn@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

FSHMN

Ref. nr. 9491

Prishtinë, Dt. 09.10.2023

**RAPORT I VLERËSIMIT TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TË DIPLOMËS
MASTER**

FAKULTETI	I SHKENCAVE MATEMATIKE-NATYRORE (FSHMN)
Departamenti/ Programi	GJEOGRAFI/GJEOGRAFI
Tema e diplomës master	Veçoritë fiziko-gjeografike, resurset natyrore dhe problemet mjedisore në pjesën e epërme të pellgut të Moravës së Binçës <i>(Eng: Physical-geographical features, natural resources and environmental problems in upper part of Morava e Binçës River basin)</i>
Kandidati	Valjet Avdyli
Mentori	Prof.asoc.dr. Valbon Bytyqi
Aprovimi i projekt propozimit në Këshillin e Fakultetit	Datë: 28.4.2022 Vendimi nr.: 1978

Në bazë të kërkesës së kandidatit **Valjet Avdyli** (dt. 22.9.2023, ref.nr.:4564) dhe me lejen e mentorit të temës, komisioni për vlerësimin e dorëshkrimit të temës master në përbërje: prof.dr. Arsim Ejupi, prof.asoc.dr. Valbon Bytyqi dhe prof.asoc.dr. Ibrahim Ramadani, paraqet këtë:

RAPORT I VLERËSIMIT TË DORËSHKRIMIT

Punimi i diplomës master me titull “**Veçoritë fiziko-gjeografike, resurset natyrore dhe problemet mjedisore në pjesën e epërme të pellgut të Moravës së Binçës**” i kandidatit **Valjet Avdyli** paraqet një hulumtim i cili realizuar nga vrojtimet në terren, shqyrtimi literaturës për veçoritë fiziko-gjeografike, resurset natyrore dhe problemet mjedisore të paraqitura si rezultat i

bashkëveprimit njeri-natyrë në pjesën e epërme të pellgut të Moravës së Binçës. Analiza e veçorive fiziko-gjeografike kërkon të kuptuarit e proceseve natyrore të cilat kanë rezultuar me paraqitjen e resurseve natyrore, ndërsa bashkëveprimi njeri-natyrë ka ndikuar në paraqitjen edhe të problemeve mjedisore.

Kandidati e ka ndarë dorëshkrimin e tij në 4 kapituj kryesorë, ndërsa në pjesën e parë ka paraqitur qëllimet, metodologjinë dhe shqyrtimin e literaturës. Qëllimi i hulumtimit ka qenë veçoritë fiziko-gjeografike, resurset natyrore dhe problemet mjedisore në pjesën e epërme të pellgut të Moravës së Binçës. Ka përdorur metoda të ndryshme hulumtimi, ku kryesorja ka qenë vrojtimi në terren, pastaj metoda krahasuese, ndërsa me anë të teknikave të GIS-it ka paraqitur disa harta të cilat e ilustrojnë më së miri proceset dhe problemet e hulumtuara. Ka analizuar disa njësi bibliografike të cilat objekt tematik të studimin kanë pasur pjesën e epërme të pellgut të Moravës së Binçës, ku veçon disa autorë fiziko-gjeografë (Pllana, Ahmetaj, Bytyqi, etj.), gjeologë (Elezaj, Pruthi, Dushi etj.).

Në kapitullin I kandidati trajton veçoritë fiziko-gjeografike të pjesës së epërme të pellgut, ku theksion shtrirjen e zonës së hulumtimit në pjesën lindore të fushëgropës së Anamoravës, si dhe të pjesës veriore të Kadarakut e jugore të maleve të Zhegocit. Konkludon se ka pozitë të mirë gjeografike, që i mundësojnë rrugët që e ndërlidhin. Në pjesën e ndërtimit gjeologjik, trajton formacionet paleozoike (shistet, gnejset, mermerët etj.), mezozoikë (serpentinitet, gabrodiabazet, konglomeratet, fllishin karbonatikë etj.), si dhe ato kenozoike (vullkanikët, sedimentet lijenore e lumore), duke theksuar se të gjitha këto i takojnë zonës gjeologo-tektonike të Vardarit. Në kuadër të veçorive relievore, trajton origjinën e krijimit të fushës dhe të maleve, duke theksuar se Anamorava paraqet një graben tektonik, ndërsa malet kanë lartësi mesatare deri të lartë, të pasura me lugina e lugje që e bëjnë më të disecuar relievin. Tek reliev, analizon edhe veçoritë morfometrike (pjerrësinë e relievit, lartësinë mbidetare etj.). Në vazhdim, ai trajton kushtet klimatike, duke analizuar faktorët kryesorë klimatikë dhe elementet klimatike, ndërsa përmes indikatorëve klimatikë përfundon se pjesa fushore ka klimë kontinentale, ndërsa në viset malore klima bëhet më e ftohtë. Tek nënkapitulli për hidrografinë, kandidati analizon kushtet hidrogeologjike e hidrografike të territorit të hulumtar, ku veçohet akuiferët me porozitet intergranular të pjesës fushore dhe ata kompakt nëpër terrenet kodrinore-malore. Ndërsa në aspektin hidrografik paraqet të dhënat për prurje dhe nivel të lumit Morava e Binçës, e cila krijohet pikërisht në këtë pjesë të zonës së hulumtimit. Kurse në vazhdim përmend karakteristikat

pedologjike dhe biogeografike, duke veçuar tokat e me kualitet të lartë në zonën fushore, ndërsa pasurinë me pyje dhe kullosa në pjesën kodrinore-malore.

Në kapitullin II, kandidati trajton pozitën e vendbanimeve dhe lëvizjen e numrit të popullsisë si elemente kryesore përmes të cilave ndikohet shfrytëzimi i resurseve natyrore dhe problemet mjedisore.

Në kapitullin III trajton resurset natyrore në pjesën e epërme të pellgut të Moravës së Binçës. Përmend praninë e mineraleve të Pb-Zn në disa lokalitete, pastaj të hekurit në Debëllden, ndërsa nga jometalet veçon bentonitet me rezerva të shumta, tufet, kuarcitet në disa lokalitete, leucitet e argjilat, të cilat mund të janë bazë e mirë për shfrytëzim për nevoja praktike. Kandidati trajton resurset klimatike të pellgut, duke veçuar shumën e temperaturës përgjatë vitit dhe poashtu në periudhën vegjetative që ka rëndësi për kultivim bujqësor. Ndërsa, tek resurset ujore trajton shpërndarjen e ujërave sipërfaqësore gjatë muajve të vitit, si dhe bën klasifikimin sipas Indikatorit të stresit ujor sipas Falkenmarkut, ku kjo pjesë e Kosovës veçohet me sasi të pakta të ujërave rrjedhëse, me $656 \text{ m}^3/\text{b/vit}$, që është ndër vlerat më të ulëta në vend. Në region mund të shfrytëzohet edhe energjia e ujërave gjeotermale përmes burimeve të ujërave termominerale. Po ashtu, tregon shpërndarjen e resurseve tokësore dhe pyjeve, ndërsa për qëllim të mbrojtjes së resurseve pyjore, përmend objektet e marra në mbrojtje nga institucionet përkatëse.

Në kapitullin IV kandidati ka trajtuar shfrytëzimin e resurseve natyrore në pjesën e epërme të pellgut të Moravës së Binçës. Trajton shfrytëzimin e gurit gëlqerorë dhe problemeve të janë paraqitur, analizon shfrytëzimin e ujit dhe problemet mjedisore, problemet që ndërlidhen me shfrytëzimin e tokave, degradimin nga erozioni e forma të tjera të degradimit të mjedisit, si dhe gjendjen e mbeturinave në këtë pjesë të Kosovës.

Dorëshkrimi përban një numër të konsiderueshëm të hartave, ilustrimeve, fotografive të terrenit që në mënyrë koncize tregojnë vrojtimet e analizuara nga kandidati për të paraqitur në mënyrë sa më koncize marrëdhëniet shkak-pasojë.

PËRFUNDIMI DHE PROPOZIMI



Nga vlerësimi i dorëshkrimit të temës së masterit të kandidatit **Valjet Avdyli**, me titull “**Veçoritë fiziko-gjeografike, resurset natyrore dhe problemet mjedisore në pjesën e epërme të pellgut të Moravës së Binçës**” mund të nxirren këto përfundime:

- Tematika e përzgjedhur për të hulumtuar proceset natyrore, resurset natyrore dhe problemet mjedisore është aktuale, andaj njohja, evidentimi mundëson të kuptuarit e marrëdhënieve shkak-pasojë, si dhe shërben si bazë e mirë për studime të mëtutjeshme;
- Nga vrojtimet në terren, duke përdorur metodat dhe teknikat bashkëkohore (MDR, harta topografike, harta gjeologjike-tektonike, imazhe satelitore etj.), kandidati ka paraqitur informacione me vlerë shkencore, të cila i ka trajtuar me metoda bashkëkohore hulumtuese, qëllimi i të cilave ka qenë arritja deri te rezultatet e pritura;
- Të dhënat e paraqitura kanë rëndësi praktike, në veçanti për të kuptuar funksionimin e proceseve fiziko-gjeografike, në veçanti shpërndarjen gjeografike të resurseve natyrore si dhe problemeve mjedisore, të cila kërkojnë edhe zgjidhje për të ofruar mundësi të zhvillimit të qëndrueshëm në regjion.

Mbështetur në vlerësimet dhe përfundimet e lartpërmendura, komisioni profesional-shkencor vlerëson se punimi i diplomës master i kandidatit **Valjet Avdyli**, me titull **“Veçoritë fiziko-gjeografike, resurset natyrore dhe problemet mjedisore në pjesën e epërme të pellgut të Moravës së Binçës”** i plotëson të gjitha kushtet formale, juridike dhe profesionale-shkencore për të kaluar në procedim të mëtutjeshëm.

Prishtinë, më 09.10.2023

Komisioni:

1. Prof.dr. Arsim Ejupi, kryetar

2. Prof.asoc.dr. Valbon Bytyqi, anëtar

3. Prof.asoc. dr. Ibrahim Ramadani, anëtar
